**REPUBLIKA E KOSOVËS**

*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

**KOMUNA E MITROVICËS JUGORE**

*Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **28.08.2025** |
| **REFERENC-Ë:** | |
| **PËR/ZA/TO:** | **Vesa BROJA** – Kryesuese e Kuvendit |
| **KOPJE :** | **Bedri HAMZA -** Kryetar i Komunës së Mitrovicës |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Igballe ISLAMI –** Drejtore për Buxhet dhe Financa |
| **NGA/OD/FROM:** | **Zenel ÇITAKU –** Udhëheqës për Buxhet dhe Financa / ZKF |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Raport për Dëgjimet Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit të vitit 2026-2028** |

E nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkorës 2026/01, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në kordinim me kryetarin e Komunës së Mitrovicës, në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive, Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2026-2028 ka bërë organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028.

Referuar në vendimin e kryetarit të komunës për formimin e Grupit Punues për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 2026-2028 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, grupi punues ka hartuar raportin me shkrim dhe i njëjti i është dërguar Drejtorëve të Drejtorive për trajtim/përgjigje në kërkesat e qytetarëve.

Në procesin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2026-2028 i kemi përfshi gjithsej 5 dëgjime buxhetore, prej të cilave dëgjimi i parë ka qenë për KAB - Komunal 2026-2028 dhe katër dëgjime për planifikimin e buxhetit komunal 2026-2028.

| Metodat e konsultimeve | Data/Kohë-zgjatja | Numri i pjesëmarrësve | Numri i atyre që kanë dhënë komente | Numri i kërkesave të pranuara |
|---|---|---|---|---|
| **Takime të drejtpërdrejta me gjithë qytetarët e komunës të organizuara nga Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2026-2028** | **08.07.2025**<br><br>**16.07.2025** | **F M T**<br>**47 55 102** | **56** | **221** |

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjime publike janë pjesë e raportit, ndërsa raporti i detajuar është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Me respekt!

**Shtojca 1** – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna nga qytetarët, të cilat i obligon drejtorët e drejtorive komunale që t'i shqyrtojnë këto kërkesa dhe varësisht nga natyra e kërkesës së qytetarëve të përgjigjet drejtoria përkatëse në dy kolonat e fundit të tabelës sipas kërkësës së tabelës.

| Temat e dëgjimit buxhetor | Kërkesat /Sygjerimet/ Komentetet | Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2026 | Statusi i kërkesës/sygjerimi i pranuar, pjesërisht i pranuar/ apo nuk është pranuar | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| **Dëgjimi i parë buxhetor me Kryetarët e Keshillave të Fshatrave për Draft-Buxhetin 2026-2028 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 08.07.2025, E Martë ora 19:00** | 1. Rregullimi komplet i rrugës sipas projektit të fshatit Koprivë dhe jo vetëm gjysma e rrugës. | Xhelazim Baliu Fsh. Koprivë | | |
| | 2. Zgjerim i rrjetit të ndriçimit dhe zgjerim të kanalizimit në rrugën e Kutllovcit, rrugicat e lagjës Tunel i Parë dhe rrugicat në fshatin Rekë. | Arsim Musa Fsh.Tunel i Parë | | |
| | 3. Ndriqimi i lagjës komplet.<br>4. Rregullimi i kanalizimit.<br>5. Rregullimin e rrugëve të mbetura.<br>6. Rregullimin e kanalizimit tek Shkolla.<br>7. Të vendosen kamera në oborrin e shkollës.<br>8. Të ndërtohet një qerdhe për fëmij. | Ragip Ahmeti Fsh. Zhabar i Epërm | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 9. Ndriçimi publik në fshatin Vërrmicë – Pirq.<br>10. Rregullimi i kanalizimit në fshatin Vërrmicë – Pirq.<br>11. Rregullimi dhe asfalltimi i disa rrugëve në fshatin Vërrmicë – Pirq e sidomos rruga per tek varrezat e fshatit Pirq. | Ramadan Rexhepi Fsh.Vërrnicë | | |
| | 12. Rregullimi i ndriçimit publik.<br>13. Rregullimin dhe asfalltimin e rrugës prej shtëpive deri tek varrezat.<br>14. Rregullimin e rrugës mbi lagjen Koloni tek shtëpija e Naimit.<br>15. Rregullimin e kanalizimit në rrugen e Kolonisë.<br>16. Rregullimin e urës së Sitnicës. | Enver Bahtiri<br><br>2 Kurriku dhe Lisicë | | |
| | 17. Rregullimi i kanalizimit ne tërë lagjen.<br>18. Vendosja e murit mbrojtës rreth shtëpive afër lumit Lushta.<br>19. Asfalltimi i rrugëve: Hamzë Jashari, Ylfete Humolli, Gucia, Shala (rr. Lidhëse), Afrim Hajrizi.<br>20. Rregullimi i rrugëve me kubëza: Ferki Aliu, Sylë Maloku, Ramadan Behrami.<br>21. Vendosja e kamerave përgjatë lumit Lushta (në mënyre që të parandalohet ndotja e lumit).<br>22. Rregullimi i rrethojes së shkollës Ismail Qemali Model. | Baki Hajrizi rr. Hamzë Jashari - Bair | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 23. Rregullimi i rrugës Trepç – Rahovë – Krshi Dudës.<br>24. Ndriçimi i lagjes Rahovë e ultë.<br>25. Trajtimi i rrugëicave në disa pjesë të lagjeve.<br>26. Ndertimi i Ambullantës (sipas mundesive).<br>27. Pastrimi i trases Rahovë e ultë – Mitroviё. | Afrim Peci<br>Fsh. Rahovë | | |
| | 28. Liqeni Akomulues dhe shtrati i degraduar të intervenohet me urgjencë.<br>29. Asfalltimi i rrugëve të lagjes psa degradimit nga një kompani "Rahovica".<br>30. Çerdhja publike në Ilиridë.<br>31. Ujrat e zeza dhe urat e të reshurave.<br>32. Salla e Ed. Fizike në shkollën ekonomike "Hasan Prishtina".<br>33. Transporti publik, ndriçimi publik, siguria publike.<br>34. Përkrahja e bizneseve të vogla, grante, makina, paisje. | Ramadan Beshiri Ilirida - Mitrovicë | | |
| | 35. Asfalltimi i rrugës "Ilmi Cimili" dhe Vocë Gimaj".<br>36. Rregullimi i rrugës "Halim Kapuqi".<br>37. Të sigurohet uji i pijshëm përfshatrat Melenicë dhe Maxher.<br>38. Të pajisen banorët e fshatit Melenicë me kontenjer të mbeturinave.<br>39. Në disa lagje të intervenohet me | Osman Cimili<br>Fsh. Melenicë | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | hapjen, zgjërim dhe shtrim me zhavor. | | | |
| | 40. Asfalltimi i rrugëve sekondare të mbetura.<br>41. Ndriçimi publik.<br>42. Ndërhyrje të rrjetit të kanalizimit.<br>43. Rregullimi i tretuarit. | Mustaf Preshtreshi Fsh. Frasher i vogël | | |
| | 44. Asfalltimi i rrugicave lagjja Lekaj.<br>45. Asfalltimi i rrugicave në lagjen Uka tek Ambollanta.<br>46. Kubëzimi i rrugicave në lagjen Hasani.<br>47. Asfalltimi i rrugicave në lagjen Behrami me rrugën regjionale Mitrovicë-Skenderajë rr. "Faqja e lmume".<br>48. Rregullimi i kanalizimit në fsh. Broboniq. | Isak Hajra Fsh. Broboniq | | |
| | 49. Rregullimi i tretuarit të rrugës kryesore.<br>50. Ndriçimi i fshatit.<br>51. Asfalltimin e rrugëve sekondare të mbetura.<br>52. Të rregullohet një stacion të pumpimit për ujë të pijshëm për pikat të larta që nuk kanë ujë të pijshëm. | Mexhit Hasani Fsh. Frashër i madh | | |
| | 53. Ura mbi lumin Sitnica drejtë Pantinës.<br>54. Ndërtimi i Çerdhes.<br>55. Asfalltimi i rr. "Haxhi Qerimi".<br>56. Rregullimi komplet i shkollës.<br>57. Asfalltimi i rr. e Malit.<br>58. Rregullimi i kanalizimit, tretuarëve, rrugicave dhe ndriçimit publik. | Fatmir Salihu Fsh. Kqiq i madh | | |
| | 59. Riasfalltimi i rrugës "Ajet Haxha Vakanicë e epërme.<br>60. Asfalltimi i rrugës | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | "Shpetimi" Vaganicë e ulët.<br>61. Riparimi i urës në Vaganicë e ulët.<br>62. Ndriçimi publik në rrugët: "Shaqir Prekazi", "Reshat Vallqi" dhe "28 Nentori" në Vaganicë të ulët. | Jakup Gashi<br>Vaganicë e ulët | | |
| | | 63. Të rregullohet tretuari i mbetur pa u përfunduar.<br>64. Asfalltimi i disa rrugëve dhe rrugicave.<br>65. Të bëhet ndriçimi i rrugëve.<br>66. Të rregullohen shtretërit e disa përrockave vërshuese.<br>67. Të rregullohen disa kanalizime. | Haxhi Salihu<br>Fsh. Koshtovë | | |
| | | 68. Hyrje në rrugë nga qyteti nuk kemi.<br>69. Të rregullohen trotuarët e urës në rrugën "Sami Gashi".<br>70. Ndërtimi i një Çerdhe për fëmij.<br>71. Ndriçimi publik. | Xhevdet Kaçiku<br>Ura e Gjakut | | |
| | | 72. Ndërtimi i një shtëpie të moshuarve.<br>73. Ndërtimi i një qendre të kulturës.<br>74. Zgjerimi i ambulantes.<br>75. Vendosja e kamerave në rrugën kryesore.<br>76. Kërkomë që parcella e Komunës të rrethohet që ti parandalojmë ozurpimet. | Salih Meha<br>Shipol | | |
| | | 77. Rregullimi i kanalizimit.<br>78. Ndriçimi publik i fshatit.<br>79. Njëfush futbolli.<br>80. Rregullimi dhe | Shahin Fetahu<br>Kqiq i vogël | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | zgjerimi i varrezave të fshatit Kqiq i vogël. | | | |
| **Dëgjimi i Dytë buxhetor Shoqëria Civile dhe Komuniteti Artisitik për Draft-Buxhetin 2026-2028 Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit 09.07.2025, e Merkurë ora 19:00** | 81. Ansambli i këngëve dhe valleve me u funksionalizu, po na duhen kostumet kombëtare për manifestim kulturore.<br>82. Me u mbështetë financiarisht projektet kulturore me temë konkretisht projekti për Gjeneralin Isa Boletini. | Adem Zhitopotoku Rr."Fadil Deliqi" | | |
| | 83. Për OJQ dhe klubet sportive të happen thirrje publike dy here në vit, si dhe të realizohen ndihmat për klubet sportive.<br>84. Turneu tradicional në futjall në nderim të komandantit Shemsi Ahmeti, të planifikohet dhe realizohet një turne ndërkomunal me pjesëmarrje nga klube edhe nga pjesa tjeter e Kosovës. | Idriz Idrizi Rr. "Marsi 81" | | |
| | 85. Buxhet shtesë pë teatrin "Muharrem Qena" për realizimin e shfaqjeve.<br>86. Rritja e numrit të të punësuarave aktore gra.<br>87. Meditjet për udhëtime në prezantime teatri.<br>88. Kamion dhe veturë zyrtare për udhëtim.<br>89. Gjenerator.<br>90. Parking.<br>91. Byfe. | Mehmet Preteni Rr. "Xhevat Jusufi" | | |
| | 92. Në të mirën kolektive jo vetëm atë individuale ne si qytet kemi mangësi për aktivitete dhe hapsira | Zana Islami Rr. "Kuvendi i | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | për secilin lloj të artit, mundësi për përdorimin e hapsirave publike për prezantimin e Arteve.<br>93. Buxheti për artista lokal për të prezantuar punën e tyre dhe mbështetje institucionale. | Arbërit" | | |
| | 94. Subvencionimi i klubeve sportive te vajzave dhe klubet e Ping Pong, Shah, që kryesisht udhëhiqen nga grate. | Valbona Sadiku Fsh. Shupkovcë | | |
| | 95. Dhënja e hapsirave të lira në Qendren e Kulturës për OJQ-të që knë nevojë për zyra.<br>96. Dhënja përparsi e festivaleve të dëshmuara të qytetit dhe të ketë buxhet special i ditur qysh në fillim të vitit, gjë që e mundëson mbështetjen e festivaleve në mënyrë më të mirë. | Erhan Mujka Mitrovicë | | |
| | 97. Për vitin 2026rritja e buxhetit për subvencione për OSHC-të, Kulturë, Rini dhe Sport.<br>98. Shfrytëzimi i hapsirave të Qendrës së Kulturës për OSHC-të. Shembull: Rrjeti i Organizatave kulturore të Mitrovicës të mirret shembull komuna Pull në Kroaci, për dhënjen në shfrytëzim të një aneksi të Qendrës së Kulturës, kurse aneksi të jetë ndarje tek organizatat | Lulzim Hakaj Rr. "Negjip Dragaj" | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | individuale siq ka qenë praktikë e mëhershme. | | | |
| | 99. Rikonstruimi i hyrjës në Qendrën e Kulturës.<br>100. Renovimi i salles së konferencave.<br>101. Renovimi i hollit të Qendrës së Kulturës.<br>102. Renovimi i salles se leximit.<br>103. Rregullimi i ventillimit.<br>104. Rifonksionalizimi i kinemas.<br>105. Shtim i stafit: organizator i aktiviteteve kulturore, elektricist, mirëmbajtës. | Naser Hajdari Rr." Fazli Barani" | | |
| | 106. Mbeshtetje financiare për OJQ Teatri "Aleksander Moisiu" për realizimin e shfaqjeve teatrale.<br>107. Projektet e ardhshme; Dram me temë nga lufta, dram për Ahmet Selacin luftëtaret e rezistencës popullore.<br>108. Monodrama "Amaneti". | Zekë Murseli Rr. "Kalabria" | | |
| | 109. Ndriçimi publik në lagjene Romve.<br>110. Te raktivizohet zyra Policore.<br>111. Ambullanta nuk është në funksion 24 orë dhe nuk ka visit mjeksore.<br>112. Të ndahen bursa për vajzat që vijojnë mesimin në shkollen e mesme. | Aurore Tahiri Rr. "Adem Voca" | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 113. Të hapet një biblotek ku mund të kalojnë kohen fëmijët.<br>114. Të hapet një biznes ku mund të punësohen grate.<br>115. Të rregullohen kanalizimet ne banesa dhe shtëpija. | | | |
| **Dëgjimi i Tretë buxhetor me Gratë dhe Vajzat për Draft-Buxhetin 2026-2028 Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit 11.07.2025, e Premte ora 19:00** | | 116. Kërkesë për sera.<br>117. Përkrahje financiare dy here në vit për barna, terapi e kontrolla. | Shukrije Shabani Rr."Deshmoret e Kombit" | | |
| | | 118. Kërkesë për hapsirë në panaire për ekspozimin e punimeve artizanale në vendlindje time në Mitrovicë. | Ajshe Pllana Mitrovicë | | |
| | | 119. Kërkesë për një vend – kiosk për shitjen e punimeve ( veshjeve kombëtare).<br>120. Kërkesë për makin qepëse. | Zade Jashari Rr, "Ukshin Hoti" | | |
| | | 121. Kërkesë për një vend – kiosk për shitjen e produkteve.<br>122. Kërkesë për makin qepëse. | Selvije Aliu Fsh.Çabër | | |
| | | 123. Kërkesë për një kiosk për shitjen e produkteve. | Hamide Tahiri Mitrovicë | | |
| | | 124. Kërkesë për një kiosk për shitjen e produkteve.<br>125. Kërkesë për makin qepëse. | Fatmire Kurti Fsh.Çabër | | |
| | | 126. Kërkesë për një kiosk për shitjen e produkteve<br>127. Kërkesë për një makin për qepje. | Fikrije Hajdari Fsh, Suhodoll | | |
| | | 128. Kërkesë për mbështetje për zgjerim të biznesit pasi punoj me kushte shtëpije. | Nazile Jashari Mitrovicë | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 129. Asfalltimi i rrugës në lagjen “Hamiti” 800m.<br>130. Ndriçimi public në rrugën kryesore të fshatit.<br>131. Transporti publik në fshat. | Miradije Hamiti Fsh. Zasellë | | |
| | 132. Kërkesë për një vend – kiosk për shitjen e produkteve tona për cdo sitin të vitit. | Shyhrete Beqiri Mitrovicë | | |
| | 133. Kërkesë për hapsirë publike për promovimin e rrobave kombëtare. | Kimete Arifi Rr. “Cen Stantergu” | | |
| | 134. Kërkesë për hapsirë publike për promovimin e produkteve tona, të kemi nga një kiosk secili biznes i vogël. | Fatmire Demiri Fsh. Pirq | | |
| | 135. Kërkesë për përkrahje me mjete pune: miksera, friz, furrë | Sadete Behrami Fsh. Broboniq | | |
| | 136. Rregullimi i rrugës Broboniq Faqja e lëmut 2/53.<br>137. Kërkesë për mbështetje për zgjerim të biznesit. | Xhevrije Doroci Fsh. Broboniq | | |
| | 138. Kërkesë për një serë. | Nafije Rama Rr. “Adriatiku” | | |
| | 139. Kërkesë për një serë.<br>140. Mbështetje me mjete financiare pasi jam e sëmur kanceri. | Halime Fejza Rr. “Sinan Sadiku” | | |
| | 141. Kërkesë për një parcel për vendosjen e disa kioskave për gra, ku at oi promovojne produktet e tyre gjatë vitit. | Melihat Beshiri Rr. “Ukshin Kovaçica” | | |
| | 142. Kërkesë për një parëcell për vendosjen e kioskav | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | për shitjen e produkteve tona.<br>143. Rregullimi i rrugës "Qazim Bistrica" në fsh. Stan terg.<br>144. Rregullimi i kulmeve të banesës. | Emine Tahiri<br>Fsh. Trepçe | | |
| | 145. Ndriçimi publik në rr. "Adem Voca".<br>146. Asfalltimi i rr. "Adem Voca".<br>147. Ambullanta nuk është në funksion 24 orë dhe nuk ka visit mjeksore.<br>148. Të përkrahen me bursa dhe punësimi i tyre për vajzat e komunitetit Ashkali.<br>149. Të hapet një biznes rrobaqepsie ku mund të punësohen grate. | Aurora Tahiri<br>Rr. "Adem Voca" | | |
| | 150. Kërkesë për një vend – kiosk për shitjen e produkteve tona. | Arbenita Brahimi<br>Rr. "Mic Sokoli" | | |
| | 151. Të rritet ndihma ose së paku dy here në vit të subvensioneohen grate e sëmura nga kanceri.<br>152. Mbështetja e grave të prekura me kancer me proteza të gjirit dhe sytjena, përmes barnatorës së QKMF-së | MWAHR - kërkesat e grave për instutucinet shëndetësore | | |
| | 153. Vazhdimi i pagesave të qirave.<br>154. Vazhdimin dhe rritjen e përkrahjeve financiare dhe ushqimore. | MWAHR - kërkesat e grave me asistencë | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 155. Të ndihmohen OJQ me persona me aftësi të kufizuar. | | | |
| | 156. Ndarja e një linje buxhetore / fondi për projekte.<br>157. Të ndahet një hapsirë, object ku pensionistet mund të takohen dhe kalojnë kohën, mundësisht hapsira të posedoj mini bibliotekë dhe materiale për argëtim.<br>158. Për grupin e grave "Gratë e Mitrovicës Lexojnë" të ndahet një hapsirë ku ato mund të takohen lexojnë dhe komentojnë romanet. Shpresojmë në objektin e bibliotekës së re të gjendet njëvend i tillë. | MWAHR - kërkesat e grave penzionere | | |
| | 159. Të rregullohet ndriçimi në rr. "Adem Voca".<br>160. Asfalltimi i rrugës "Adem Voca".<br>161. Në lagjen "Adem Voca" në ambullantë nuk ka mjekë të rregulltë si dhe mungojnë visitat.<br>162. Të përkrahen me bursa dhe punësimi i tyre për vajzat e komunitetit Ashkali.<br>163. Të hapet një biznes rrobaqepsie në Roma mahallë ku mund të punësohen gratë Rome. | MWAHR - kërkesat e grave nga komuniteti Rome dhe Ashkalike | | |
| | 164. Vendosja e kioskave të premtuara nga Komuna në një hapsirë të caktuar.<br>165. Të përcaktohet vendi për organizimin | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | e panaireve – sheshi “Adem Jashari- promovim të produkteve tradicionale dhe turizmi një here në muaj.<br>166. Mbështetje me sera 50m dhe 100m.<br>167. Mbështetje të ndërrmarrëseve start up po edhe të atyre që janë në funksion me mjete pune: paisje pë rrobaqepësi, paisje për frizere, paisje për pastiqeri, paisje për pastrim.<br>168. Paisje për zhvillim të bletarisë me pajisje përkatëse.<br>169. Mjete bujqësore: freza, multikultivator.<br>170. Paisje për media sociale web dizajn.<br>171. Promovimi i produkteve tradicionale dhe turizmit.<br>172. Të bëhet harmonizimi i ligjit për trashigimi dhe kritereve të subvensioneve nga komuna (gratë nuk posedojnë prona dhe nuk mund të jenë shpeshë përfituse të subvencioneve).<br>173. Të parashihet një linjë e posaqme tek planifikimi i subvencioneve për ndërrmarrësi të grave zgjërim biznesi.<br>174. Të përkrahen bizneset e grave të komunave veriore.<br>175. Të | MWAHR - kërkesat e grave ndërrmarrëse | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | organizohen trajnime për veprimtari me të cilat merren grate. | | | |
| | 176. Të sigurohet transporti për anëtarët e organizates "Së Bashku", persona me aftësi të kufizuar.<br>177. Të ju mundësohet qasja në katet e epërme të objektit të komunës personave me aftësi të kufizuar.<br>178. Në objektit të komunës të vendosen tualete për persona me aftësi të kufizuar.<br>179. Të vendosën vijat për të verbër dhe për karroca.<br>180. Tek Qendra e Kulturës aneksi B në zyret shoqatave e sidomos shoqatës së të verberve të rregullohen tualetet dhe shkallët.<br>181. Të punësohen persona me aftësi të kufizuar, jo vetëm si praktikanta për disa muaj. | MWAHR - kërkesat e përsonave me aftësi të kufizuar | | |
| | 182. Asfalltimi i rrugës "Adem Voca".<br>183. Ndriçimi i rrugës "Adem Voca".<br>184. Ndriçimi i rrugës "Mic Sokoli" në Shipol.<br>185. Rregullimi i shkallëve në Qendren e Kulturë, kërkesë e shoqatës së të verbërve, shkallët të kenë pjerinë.<br>186. Rregullimi i objektit tek Qendra e Kulturës, kërkesë e shoqatave të dala nga lufta. | MWAHR - Shërbimet Publike | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 187. Rregullimi i parkut me lodra dhe atraksion pë fëmi dh të moshuar.<br>188. Rregullimi i trotuarit në rrugën e Kovaceve "Ahmet Selaci" si dhe gjelbrimin e lagjës me mbjelljen e drunjëve. | | | |
| | 189. Bursa për vajzat Rome/Ashkalike të cilat vijojnë mësimin në shkollat shqipe në Mitrovicën Jugore si dhe për nxënesit në shkolla profesionale dhe vajzave nga vendet rurale.<br>190. Shkolla fillore "Eqrem Qabej" të krijohet një hapsirë më e madhe për kabinetin e Informatikës.<br>191. Qendra për mësim dual.<br>192. Renovimi i kulmit në shkollën e Zhabarit.<br>193. Paisja e kabineteve me mjete pune në shkolla fillore dhe të mesme.<br>194. DKRS së bashku me të rinjët të organizon trajnime programuese, për t'ju mundësuar të rinjëve punësim më të lehtë. | MWAHR - kërkesat e vajzave të reja | | |
| | 195. Të promovohen klubet e grave në media dhe tek sponzorët më shumë.<br>196. Të rritet buxheti mbështetës i OJQ-ve sportive.<br>197. Të ndërtohet | MWAHR - Kërkesat për DKRS | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | një fushë sporti për klubin futbollist të grave.<br>198. Thirrjet publike për mbështetje të bëhen në fillim të vitit.<br>199. Të sigurohen hapsira- zyra OJQ të grave active. | | | |
| | | 200. Të rritet buxheti për ndarjen e granteve për grupe të grave të shoqërisë civile.<br>201. Të rritet shuma e grantit për përfituesit e granteve nga zyra për barazi gjinore. | MWAHR - Kërkesa e përfaqësuesve të shoqërisë civile | | |
| **Dëgjimi i Katërtë buxhetor me Komunitete të jo shumicë për Draft-Buxhetin 2026-2028 Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit 16.07.2025, e Merkurë ora 19:00** | | 202. Për përkrahje më të shtuar për OJQ apo shoqata të komunitetit Turk. Të mos jetë vetëm shuma simbolike por të jetë me të vërtetë përkrahje që stimulon komunitetin për zhvillimin e projekteve më të mëdha dhe kualitative. | Metin Zekerija Rr. "Agim Ramadani – Katana" | | |
| | | 203. Rritja e buxhetit për zyrën e ZKK.<br>204. Përfundimi i projektit të Qendres Multifunksionale në lagjën "Agim Ramadani – Katana".<br>205. Planifikimi i buxhetit për funksionalizimin e organogramit për funksionimin e qendrës.<br>206. Ndriçimi publik në rr. "Agim Ramadani – Katana" të jetë funksionale | Agon Jashari Rr. "Agim Ramadani" dhe rr. "Kumanova" | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | gjatë natës.<br>207. Përfaqsimi i komunitetit Turk nëpër drejtoritë përkatëse në K.Mitrovicës Jugore.<br>208. Hapja e rrugës nga ndërtimet (objektet) e mbetura në rrugën "Kumanova' që lidhë rr. " Agim Ramadani – Katana".<br>209. Planifikimi i buxhetit për dezinfektimin, dezinsektimin dhe deratizimin për të gjithë qytetitn e Mitrovicës e në veçanti lagjet e populluara nga komunitetet Rome, Ashkali, Egjiptjanë. | | | |
| | 210. Për mësimnxënje në klasat e ulëta në gjuhen Turke, mësimi mbahet në një klasë (1-5) të përziera. Në vitin shkollor 2025-2026 në klasën e parë kemi të regjistruar pesë nxënës të ri dhe kemi nevojë për një mësuese shtesë. Dmth klasa 1-5 të kenë dy mësuese për një mësim më kualitativ. | Ergin Kani<br>Rr. "Mbretëresha Teuta" | | |
| | 211. Renovimi i shtëpisë në lagjen "Adem Voca".<br>212. Rregullimi i kanalizimeve dhe trajtimi i mbeturinave. | Tensa Hangjic<br>Rr. Adem Voca | | |
| | 213. Kërkesë për renovimin e çatisë, është dëmtuar në kohën e vërshimeve të forta bashkë me | Sadik Delic<br>Rr. "Ylfete Humolli" | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | erëra të fuqishme. | | | |
| | 214. Kërkesë për rregullimin e gypave të kanalizimit dhe pastrimin e banesave prej ujit dhe mbeturinave.<br>215. Kërkese për punësimin e dy punëtorëve për pastrimin e mbeturinave. | Ali Hajdini Rr. "Adem Voca" | | |
| | 216. Ritje e buxhetit për ZKK.<br>217. Rregullimi dhe ndriçimi i rrugëve "Adem Voca" dhe "2 korrik"<br>218. Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica.<br>219. | Bashkim Krasniqi Lagjja "2 Korriku" | | |
| | 220. Ndriçimi publik në lagjen "Adem Voca" si dhe renovimi i shtëpive të cilat në kohën e dimrit kanë mykë dhe janë të ftohta brenda.<br>221. Kërkesë për mjek familjar dhe pediatër si dhe furnizim me barna në AMF. | Artan Bajrami Rr. "Adem Voca" | | |